Vlerësimi i

QEVERISJA E MIRË NË NJËSITË VETËQEVERISJES LOKALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT PËRMES INDEKSIT TË TRANSPARENCËS

MATJE PËR VITIN 2022

USAID
NGA POPULLI AMERIKAN

Vlerësimi i

QEVERISJA E MIRË NË NJËSITË E VETËQEVERISJES LOKALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT PËRMES INDEKSIT TË TRANSPARENCËS

MATJE PËR VITIN 2022

Shkup, gusht 2022

USAID
NGA POPULLI AMERIKAN

Ky botim është përgatitur nga Fondacioni Metamorfozis në kuadër të Projektit për pjesëmarrje qytetare me mbështetje të popullit amerikan përmes Agjencisë së SHBA-së për zhvillim ndërkombëtar (USAID). Mendimet e shprehura në këtë botim nuk i pasqyrojnë qëndrimet e Agjencisë së SHBA-së për zhvillim ndërkombëtar ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Përmbajtja

1. HYRJE 7

2. METODOLOGJIA 8

3. TRANSPARENCA E INSTITUCIONEVE NGA PUSHTETI LOKAL NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT 10

3.1. GJENDJA E QEVERISJES SË MIRË NË INSTITUCIONET E PUSHTETIT LOKAL NË MAQEDONINË E VERIUT 10

3.2. TRANSPARENCA 16
3.2.1. Angazhimi për transparencë dhe llogaridhënie 17
3.2.2. Informata organizative 19
3.2.3. Miratimi i vendimeve 20
3.2.4. Transparenca financiare 21

3.3. VETËDIJA 22
3.3.1. Planifikimi dhe programimi 24
3.3.2. Monitorimi dhe evaluimi 25

3.4. QASSHMËRIA 25
3.4.1. Qasja në informata dhe shërbime 27
3.4.2. Konsultime publike 28
3.4.3. Bashkëveprimi me qytetarët 29

3.5. INTEGRITETI 29

3.6. TË DHËNA TË HAPURA 31

3.7. KËSHILLAT KOMUNALE DHE NDËRMARRJET PUBLIKE 32

4. KONKLUZION 33

5. REKOMANDIMET PËR QEVERISJE TË MIRË TË VETËQEVERISJES LOKALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT 35

Titulli i origjinalit: Проценка на доброто управување во единиците на локалната самоуправа во Република Северна Македонија преку Индексот на отвореност – мерење за 2022 година

© 2022 Fondacioni për internet dhe shoqëri Metamorfozis
Shkup, gusht 2022

Botues: Fondacioni për internet dhe shoqëri Metamorfozis, rr. „Apostoll Gusllarot" nr. 40, 1000 Shkup, Maqedonia e Veriut

Autor: Memet Memeti (Мемет Мемети), Fondacioni për internet dhe shoqëri Metamorfozis (Фондација за интернет и општество Метаморфозис)

Redaktor: Bardhyl Jashari, Fondacioni për internet dhe shoqëri Metamorfozis (Бардил Јашари, Фондација за интернет и општество Метаморфозис)

Dizajni: Polyesterday DOOEL, Skopje, Maqedonia e Veriut

Lektura: Bestel DOOEL Skopje, Maqedonia e Veriut

Përkthyes: Bestel DOOEL Skopje, Maqedonia e Veriut (përkthim nga gjuha maqedonase në shqip)

Shtypi: Polyesterday DOOEL, Skopje, Maqedonia e Veriut

Tirazhi: 95 ekzemplarë

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје
352:005.332.5(497.7)"2022"(047.31)
MEMETI, Memet
Vlerësimi i qeverisja e mirë në njësitë e vetëqeverisjes lokale në republikën e maqedonisë së veriut pëermes indeksit të transparencës : matje për vitin 2022 / [autor Memet Memeti]. - Shkup : Fondacioni Metamorfozis, 2022. - 45 стр. : илустр. ; 25 см
Превод на делото: Проценка на доброто управување во единиците на локалната самоуправа во Република Северна Македонија преку Индексот на отвореност : мерење за 2022 година
ISBN 978-608-263-094-6
а) Локална самоуправа – Транспарентност – Македонија – 2022 – Истражувања
COBISS.MK-ID 58048773

1.

HYRJE

Fondacioni për internet dhe shoqëri Metamorfozis, me mbështetjen e Projektit të USAID-it për pjesëmarrje qytetare, bëri një vlerësim të gjendjes së qeverisjes së mirë të njësive të vetëqeverisjes lokale (NJVL) në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2022.

Vlerësimi është rezultat i sondazhit të kryer bazuar në Indeksin e transparencës, qëllimi i të cilit është të përcaktojë shkallën në të cilën respektohen parimet e qeverisjes së mirë.

Indeksi i transparencës është metodologji për vlerësimin e funksionimit të NJVL-ve që bazohet në Indeksin tashmë të përpiluar për matjen e transparencës së njësive të vetëqeverisjes lokale në rajonin e gjashtë vendeve që nuk janë anëtare të BE-së në Evropën Juglindore (EJL6). Indeksi merr parasysh dallimet dhe specifikat e secilit prej vendeve, si në aspekt të detyrimeve ligjore për NJVL-të, ashtu edhe në aspekt të praktikave. Metodologjia u rishikua në fillim të vitit 2021 për t'i përshtatur komponentët e indeksit (sferat, nënsferat, treguesit, mjetet) për të mundësuar zbatueshmërinë dhe rëndësinë e plotë të tij për vlerësimin e transparencës së NJVL-ve në Republikën e Maqedonisë së Veriut (RMV).

Ky raport ofron analizë të punës së njësive të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut në aspektin e parimeve të transparencës, vetëdijes, qasshmërisë dhe integritetit. Gjithashtu, NJVL-të u monitoruan sipas një domeni të përbashkët të pranishëm në të katër parimet, e ato janë të dhënat e hapura.

Në bazë të vlerësimit të bërë janë dhënë rekomandime për përmirësimin e funksionimit të njësive të vetëqeverisjes lokale në fushat e përfshira me sondazhin.

2.

METODOLOGJIA

Indeksi i transparencës vlerëson performancat e qeverisjes lokale në fushën e qeverisjes së mirë duke u fokusuar në katër parime: (1) transparenca, (2) vetëdija, (3) qasshmëria dhe (4) integriteti dhe një domen i përbashkët i pranishëm në të katër parimet - të dhëna të hapura.

Indeksi i transparencës është një mjet praktik për matjen e transparencës së përgjithshme të NJVL-ve, që:

- jep pasqyrë të detajuar të të gjitha aspekteve lidhur me transparencën e çdo NJVL-je.
- mundëson krahasueshmëri ndërmjet NJVL-ve me qëllim nxitjen e mësimit dhe ndarjes së ndërsjellë të praktikave më të mira,
- krijon motivim te NJVL-të për përmirësimin, përsosjen dhe inovacionin e vazhdueshëm,
- është i arritshëm dhe i kuptueshëm që qytetarët të kenë qasje në transparencën e komunës së tyre, si një prej kritereve kryesore për vlerësimin e performancës dhe suksesit.

Treguesit janë të organizuar në 4 sfera dhe 9 nënsfera. Të katër sferat korrespondojnë me katër parimet e qeverisjes së hapur: transparenca, vetëdija, qasshmëria dhe integriteti. Gjithashtu, indeksi përmban edhe dy nënkategori – këshillin komunal dhe ndërmarrjet publike, gjë që mundëson vlerësimin e transparencës së komunës kur bëhet fjalë konkretisht për punën e këshillit apo ndërmarrjeve publike.

Sfera **transparenca** ka të bëjë me politikat, aktivitetet dhe masat të cilat i ndërmerr komuna për t'i informuar qytetarët e saj për punën e saj. Duke u nisur nga pozita se transparenca është baza e të qenët të hapur komunat, kjo sferë në indeksin përmban më së shumti indikatorë, duke e përfshirë edhe transparencën financiare si një prej aspekteve më të rëndësishme të punës së komunave.

Sfera **vetëdija**, ka të bëjë me cilësinë e planifikimit, programimit, monitorimit dhe evaluimit të politikave që zbatohen nga institucionet. Ajo e nënkupton parashikueshmërinë e zbatimit të interesit publik përmes politikave publike në njësinë e vetëqeverisjes lokale. Kjo sferë e shqyrton procesin e krijimit të politikave publike në komunën, përgatitjen dhe miratimin e dokumenteve strategjike, plan veprimeve, si dhe zhvillimin e planit dhe mjeteve për monitorim dhe vlerësim gjatë zbatimit të kompetencave sektoriale që i ka komuna.

Sfera **qasshmëria** ka të bëjë me mënyrën në të cilën NJVL-të komunikojnë dhe i përfshijnë qytetarët nga komuna gjatë përgjigjes së kërkesave të tyre dhe përmbushjes së nevojave të tyre. Qasshmëria është e lidhur me sigurimin dhe respektimin e procedurave për qasje të lirë në informatat, përmirësimin e qasshmërisë së informatave përmes mekanizmave për debat publik dhe përforcimin e bashkëveprimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve.

Sfera **integriteti** në kuadër të këtij Indeksi shqyrtohet në funksion të respektimit konsistent të vlerave, parimeve dhe normave etike të cilat kanë për qëllim dhënie prioritet interesit publik në vend të atij privat.

Të dhënat e hapura janë aspekt i rëndësishëm i këtij Indeksi dhe shqyrtohen si sferë horizontale. Në pajtim me **Strategjinë për të dhëna të hapura**, të dhënat e hapura njihen si mundësi për avancimin e qeverisjes në aspekt të transparencës dhe llogaridhënies në të gjitha nivelet, përfshirë edhe atë lokal, e gjithashtu mund të jenë edhe nxitje e fuqishme për zhvillimin ekonomik dhe social në shtet. Në kuadër të Indeksit për pjesën e indikatorëve analizohet mënyra e publikimit të të dhënave dhe formati i tyre në prizmin e transparencës së të dhënave.

Kështu që përmes kësaj qasje horizontale, insistojmë që ta vlerësojmë angazhimin e komunave për përmbushjen e kërkesave për të dhëna të hapura.

Përpilimi dhe revizioni i Metodologjisë u bënë mbi bazën e një analize të detajuar të kornizës nacionale strategjike dhe ligjore të RMV-së, dokumenteve ndërkombëtare, iniciativave, standardeve, rekomandimeve dhe praktikave të mira, sondazheve mbi perceptimet dhe pritjet e qytetarëve të RMV-së, si dhe intervistave me faktorët relevante.

Sondazhi u realizua nga Fondacioni Metamorfozis, dhe në procesin e realizimit të sondazhit u përfshinë 8 organizata civile lokale: AGTIS - Prilep, Qendra për Dialog Ndërkulturor - Kumanovë, Fondacioni për Zhvillimin e Bashkësisë Lokale - Shtip, Qendra për Inovacione Sociale Blink 42-21 - Shkup, Multikultura - Tetovë, Skaj Plus - Strumicë, Agjencia për Zhvillim Lokal - Strugë dhe Kuantum Prima - Kavadar.

Me sondazhin për vitin 2022 u përfshinë të gjitha 80 komunat dhe qyteti i Shkupit.

Sondazhi është realizuar nga 15 shkurti deri më 1 prill 2022. Metodat e sondazhit ishin përmes (1) kontrollimit të ueb faqeve të komunave sipas treguesve të përcaktuara dhe (2) pyetësorit të dorëzuar në komunat për të vërtetuar konstatimet e marra nga monitorimi online. Metodologjia si burim bazë për mbledhjen e informacioneve i merr ueb faqet zyrtare të NJVL-ve. Niveli i dytë i kontrollit për një pjesë të treguesve nënkuptonte proces të përgatitjes dhe realizimit të pyetësorit si mjet hulumtimi. Pyetësori u realizua në mënyrë elektronike dhe përbëhej nga pyetje dhe opsione të paracaktuara për përgjigje që mundësojnë konfirmimin ose plotësimin e disa prej konstatimeve të marra përmes monitorimit të ueb faqeve, si dhe të eliminohen lëshimet eventuale gjatë monitorimit të cilat do të jenë në dëm të vlerësimit për NJVL-të për tregues konkret.

Gabimi i matjes është ± 3%. Bazuar në rezultatet e sondazhit, kemi bërë analizë me pikat dhe problemet kryesore kritike në fushën e hapjes së komunave, të cilat shpresojmë se do të përdoren për të përmirësuar punën e tyre.

Nga 80 komunat e monitoruara dhe Qyteti i Shkupit, 36 ose 44% i janë përgjigjur pyetësorit online. Është e rëndësishme të theksohet se në rastet kur komunat nuk dorëzuan pyetësorë të përgjigjur, u dhanë 0 pikë për treguesit, përkatësisht u vlerësua sikur treguesit nuk janë plotësuar. Gjegjësisht, nga komunat e monitoruara, pyetësorit i janë përgjigjur 36 (44%), ndërsa 45 të tjerat (56%) marrin automatikisht 0 për treguesit përkatës ku burimi i informacionit është përgjigjja e vetme nga komuna.

Në Shtojcën 1 mund ta shihni strukturën e përgjithshme të Indeksit të transparencës në nivel lokal.

3.

TRANSPARENCA E INSTITUCIONEVE NGA PUSHTETI LOKAL NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

3.1. GJENDJA E QEVERISJES SË MIRË NË INSTITUCIONET E PUSHTETIT LOKAL NË MAQEDONINË E VERIUT

Në tetor 2021 u mbajtën zgjedhjet lokale, ku shumë nga komunat morën autoritete të reja lokale. Komunat dhe qytetarët ende po përballen me pasojat e krizës shëndetësore dhe në vitin 2022 edhe të krizës globale energjetike-ekonomike. Zgjedhjet, ndryshimi i pushtetit lokal, si dhe ndikimet negative nga kriza shëndetësore-ekonomike janë reflektuar në funksionalitetin edhe të sektorit publik, përfshirë edhe të njësive të vetëqeverisjes lokale. Nga ana tjetër, qytetarët gjithnjë e më shumë kanë nevojë për qasje të shpejtë dhe të lehtë në informatat për shërbimet e ofruara nga komunat, por edhe për punën e organeve komunale (kryetari dhe këshilli). Në kushtet e krizës ekonomike, qytetarët bëhen gjithnjë e më të ndjeshëm në lidhje me transparencën dhe llogaridhënien e autoriteteve lokale, para së gjithash për punën e tyre financiare dhe për efektet e punës përmes cilësisë dhe çmimeve të shërbimeve.

Vendi ynë ka kornizë ligjore pozitive sa i përket qasjes në informata në përputhje me Ligjin për qasje në informata publike, i cili rregullon edhe çështjen e sigurimit të transparencës aktive, si dhe në përputhje me Ligjin për vetëqeverisje lokale me të cilin komunat janë të obliguara të publikojnë informata për punën e organeve komunale dhe për shërbimet që ato ofrojnë, megjithëse mungon një kornizë e përpunuar më hollësisht që do të vlejë vetëm për vetëqeverisjen lokale, në formë kodi apo akti nënligjor.

Sondazhi për vitin 2022 krahasuar me vitin 2021 tregoi se ndryshimi i pushtetit lokal, në përgjithësi, nuk çoi në ndryshime të dukshme lidhur me zbatimin e standardeve të transparencës, megjithëse ka ndryshime në renditjen e komunave.

Rezultatet në sferat tregojnë se NJVL-të ende zbatojnë standarde të ulëta për konsultime, transparencë, monitorim dhe kontroll në punën e tyre. Megjithëse në rrethana të jashtëzakonshme është e pashmangshme ulja e efektivitetit dhe efikasitetit në punën në disa sfera, ajo duhet të jetë e kufizuar në vëllim dhe kohë për të shmangur krijimin e perceptimit negativ tek qytetarët për kompetencën dhe transparencën e NJVL-ve. Rezultati mesatar i njësive të vetëqeverisjes lokale sipas sondazhit të Indeksit të transparencës për vitin 2022 është 27%. Ky është një tregues i nivelit të ulët të transparencës në punën e pushtetit lokal në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Komunat vlerësimin mesatar më të lartë e kanë për treguesit në sferën e transparencës, 34%, dhe vlerësimin mesataren më të ulët në sferën e vetëdijes, 13%, njësoj si vitin e kaluar.

Grafiku 1:
Transparenca e NJVL-ve për vitin 2022 sipas parimeve të Indeksit të transparencës



Rezultati shumë i ulët në sferën e vetëdijes tregon cilësinë e dobët të planifikimit, programimit, monitorimit dhe evaluimit të politikave të cilat zbatohen nga NJVL-të. Kjo është me rëndësi të veçantë sepse realizimi i interesit publik fillimisht duhet të jetë përmes politikave publike në njësinë e vetëqeverisjes lokale. Në përputhje me Ligjin për organizimin territorial të vetëqeverisjes lokale, vetëqeverisja lokale është organizuar në 80 komuna dhe qytetin e Shkupit, si njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale. Sipas Kushtetutës sonë, njësitë e vetëqeverisjes lokale, përkatësisht komunat janë të barabarta në të drejtat dhe detyrat e tyre, pa dallim të karakterit të tyre urban ose rural, shkallës së zhvillimit, madhësisë hapësinore dhe demografike dhe dallimeve dhe specifikave tjera. Së këndejmi, në sondazhin të gjitha komunat janë trajtuar barazisht, pa dallim të madhësisë, numrit të të punësuarve dhe ngjashëm. Parimet e transparencës të përfshira në Indeksin e transparencës janë përfshirë në një sërë ligjesh, aktesh nënligjore dhe manuale me qëllim përmirësimin e transparencës së institucioneve të pushtetit lokal dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës së qytetarëve. Indeksi i transparencës tregoi se në matjen për vitin 2022 rezultate më të mira kanë komuna e Vallandovës (62%), Prilepit (59%), Manastirit (57%), Ohrit (54%), Koçanit (52%) si dhe Velesit dhe Dellçevës, Demir Hisarit dhe Krushevës (50%) dhe Vasilevës (47%), ndërsa me rezultate më të ulëta renditen komuna e Dollnenit (9%), Vrapçishtes (8%), Karbincit (7%), Butelit (6%), Sopishtes (5%), Haraçinës dhe Zelenikovës (3%) dhe komuna e Krivogashtanit me 0%. Vlera 0 për komunën e Krivogashtanit është rezultat i sulmeve të hakerëve dhe pyetësorit të përgjigjur. Në raport me vitin 2021 ka zhvendosje në renditje, në vend të Ohrit, në pozitën e parë tani është Vallandova dhe më të suksesshme janë komunat urbane që kanë resurse më të mira njerëzore dhe financiare.

Grafika 2:

10 NJVL-të me renditje më të lartë sipas Indeksit të transparencës për vitin 2022



Grafiku 3:

NJVL-të me renditje më të ulët sipas indeksit të transparencës



Lidhur me rajonet e planit, sondazhi tregon se edhe në vitin 2022 më transparente janë komunat në Rajonin juglindor, me transparencë mesatare prej 35%, ndërsa më pak transparente janë komunat në rajonin e Shkupit me transparencë mesatare prej 20%, në vend të rajonit të Pollogut në vitin 2021 i cili tani e ka vendin e parafundit me 21%.

Grafiku 4:
Transparenca e rajoneve të planit për vitin 2022



Nga 80 komuna dhe qyteti i Shkupit, përmbushje të treguesve të Indeksit të transparencës prej 50% ose më shumë kanë vetëm 8 komuna urbane dhe asnjë rurale.

Përmbushje të treguesve të Indeksit të transparencës deri në 25% kanë 42 komuna nga të cilat 15 janë urbane dhe 27 janë rurale.

Të dhënat nga ky raport tregojnë se vetëm komunat urbane kanë indeksin më të lartë të transparencës, komunat urbane sërish mbizotërojnë me vlerë mesatare dhe komunat rurale me vlerat më të ulëta.

Rezultatet e komunave lidhur me matjen e Indeksit të transparencës për vitin 2022 janë si në vijim:

Rend.	**Komuna**	Përqindja totale e transparencës
1.	**Vallandovë**	62 %
2.	**Prilep**	59 %
3.	**Manastir**	57 %
4.	**Ohër**	54 %
5.	**Dellçevë**	52 %
5.	**Veles**	52 %
5.	**Koçan**	52 %
6.	**Krushevë**	50 %
6.	**Demir Hisar**	50 %
7.	**Vasilevë**	47 %
8.	**Berovë**	44 %
9.	**Kavadar**	42 %
9.	**Bogdancë**	42 %

9.	**Kriva Pallankë**	42 %
10.	**Karposh**	41 %
11.	**Konçe**	40 %
12.	**Ilinden**	39 %
13.	**Gjevgjeli**	37 %
14.	**Aerodrom**	36 %
14.	**Sveti Nikollë**	36 %
15.	**Vevçan**	35 %
15.	**Qendra Zhupa**	35 %
16.	**Struga**	34 %
17.	**Zhelinë**	33 %
18.	**Dibër**	32 %
18.	**Debërcë**	32 %
18.	**Kisella Vodë**	32 %
19.	**Radovish**	31 %
19.	**Bërvenicë**	31 %
20.	**Mogillë**	30 %
20.	**Gradsko**	30 %
20.	**Strumicë**	30 %
21.	**Shtip**	29 %
21.	**Zërnovcë**	29 %
22.	**Qyteti i Shkupit**	28 %
23.	**Tetovë**	27 %
23.	**Novac**	27 %
23.	**Çashkë**	27 %
23.	**Gazi Babë**	27 %
24.	**Kumanovë**	26 %
25.	**Gostivar**	24 %
26.	**Kratovë**	23 %
26.	**Likovë**	23 %
26.	**Qendër**	23 %
26.	**Bosilovë**	23 %
27.	**Gorçe Petrov**	22 %
27.	**Pehçevë**	22 %
27.	**Vinicë**	22 %

27.	**Makedonska Kamenicë**	22 %
27.	**Kërçovë**	22 %
27.	**Tearce**	22 %
27.	**Demir Kapi**	22 %
27.	**Novo Sello**	22 %
28.	**Resnjë**	21 %
29.	**Makedonski Brod**	20 %
30.	**Rosoman**	19 %
30.	**Probishtip**	19 %
31.	**Mavrovë dhe Rostushë**	18 %
31.	**Petrovec**	18 %
32.	**Dojran**	17 %
32.	**Negotinë**	17 %
32.	**Çeshinovë-Obleshevë**	17 %
33.	**Çair**	15 %
34.	**Nagoriçani i Vjetër**	14 %
34.	**Plasnicë**	14 %
35.	**Llozovë**	13 %
35.	**Rankovcë**	13 %
35.	**Shuto Orizar**	13 %
35.	**Saraj**	13 %
35.	**Studeniçan**	13 %
35.	**Jegunovcë**	13 %
36.	**Bogovinjë**	12 %
37.	**Çuçer-Sandevë**	11 %
38.	**Dollnen**	9 %
38.	**Sopishtë**	9 %
39.	**Vrapçishtë**	8 %
40.	**Karbincë**	7 %
41.	**Butel**	6 %
42.	**Zelenikovë**	3 %
42.	**Haraçinë**	3 %
43.	**Krivogashtan**	0 %

3.2. TRANSPARENCA

"Transparenca" u referohet politikave, aktiviteteve dhe masave të cilat i ndërmerr komuna për t›i informuar qytetarët për punën e saj. Transparenca dhe llogaridhënia duhet të jenë parimet fillestare në funksionimin e komunave. Megjithëse në mënyrë deklarative të gjitha NJVL-të zotohen për një transparencë më të madhe, në fakt shumë pak prej tyre publikojnë të gjithë informatat e nevojshme në lidhje me punën e tyre. Ekzistenca e mjeteve bazë për informimin e qytetarëve është obligim ligjor i komunave. Qasshmëria dhe funksionaliteti i mjeteve informative është përcaktim i komunës për t›ua prezantuar informatat qytetarëve të saj në mënyrën më të përshtatshme. Publikimi dhe qasja në informatat për punën e komunave, buxhetet, shpalljet publike të kontratave, vendimet e punësimit apo prokurimet publike nëpërmjet internetit e përforcon kontrollin dhe mbikëqyrjen e jashtme nga organizatat civile, ekspertët dhe publiku në përgjithësi. Transparenca më e madhe e NJVL-ve është gjithashtu një mjet i rëndësishëm në luftën kundër dezinformimit dhe lajmeve të rreme. Sondazhi i vitit 2022 tregoi se kishte komuna (2) që nuk kishin ueb faqe funksionale në tremujorin e parë të vitit 2020. Një pjesë e madhe e komunave që kanë ueb faqe funksionale janë zhvilluar në nivel shumë të ulët, disa nuk janë në domenin gov.mk, e disa nuk i plotësojnë kushtet për siguri kibernetike. Njësitë e vetëqeverisjes lokale plotësojnë 36% të indikatorëve të përfshirë në sferën e transparencës.

Grafiku 5:
Transparenca e NJVL-ve sipas katër nënsferave



Ky rezultat tregon se transparenca e NJVL-ve duhet të përmirësohet dukshëm. Autoritetet lokale duhet të publikojnë në mënyrë proaktive sa më shumë që është e mundshme informata në ueb faqen e komunave sepse ato në kohën e sotme janë burimi kryesor i informatave për cilësinë e qeverisjes. Komunat duhet të bëjnë përpjekje për ta rritur transparencën e përgjithshme në punën e tyre, e veçanërisht publikimin e të dhënave në lidhje me vendimet që i sjell kryetari i komunës dhe këshilli, si dhe të dhënat lidhur me punën financiare.

Ligji për qasje të lirë në informatat jep bazë të mirë për kuptim më të mirë të transparencës aktive ose se çfarë duhet të publikohet në ueb faqet e komunave, sipas kategorive, por, nevojitet që kjo listë e informatave të konkretizohet në kodin ose aktin nënligjor në pajtim me kompetencat e komunave dhe informatave që i krijojnë në punën e tyre, si dhe informatat për punën e organeve të komunës (kryetari i komunës dhe këshilli) me interes për qytetarët.

Lidhur me transparencën rezultati mesatar është 34%, përsëri rezultate më të mira tregoi komuna e Vallandovës (74%), e vlerësim më të ulët kishte komuna e Krivogashtanit (0%).

Grafiku 6:
10 komunat me renditje më të lartë në sferën Transparencë



Gjatë sondazhit u vërejt se numër i madh i informatave të rëndësishme, dokumenteve dhe të dhënave të rëndësishme NJVL-të i publikojnë vetëm në fletoret zyrtare. Kjo tregohet si praktikë negative në punën sepse të dhënat e publikuara në këtë mënyrë gjenden dhe përpunohen shumë vështirë. Është e dukshme se qytetari i rëndomtë në shumicën e rasteve nuk do të mund të arrijë aspak në informatën e dëshiruar e cila është e publikuar në fletoret zyrtare ose në cilëndo mënyrë tjetër jashtë ueb faqes së komunës, me çka nuk përmbushet qëllimi i tyre kryesor – informimi i qytetarëve. Këto të dhëna dhe informacione duhet të strukturohen mirë dhe të publikohen drejtpërdrejt në kuadër të menysë dhe seksioneve të ueb faqeve të komunave me qëllim për të qenë të arritshme, të parashikueshme dhe të krahasueshme lehtësisht.

Në sferën e transparencës treguesit janë organizuar në katër nënsfera:

- Angazhimi për transparencë dhe llogaridhënie që i përfshin politikat për transparencë dhe llogaridhënie dhe trajnimin e vazhdueshëm në atë temë;
- Informatat organizative të cilat kanë të bëjnë me strukturën e komunës, kompetencat themelore dhe çështjet kadrovike;
- Miratimi i vendimeve, nga Këshilli dhe kryetarët e komunave;
- Transparenca financiare e cila i përfshin prokurimet publike, buxhetin, llogaritë përfundimtare dhe raportet financiare.

3.2.1. Angazhimi për transparencë dhe llogaridhënie

Ekzistimi i politikës së qartë për transparencë, llogaridhënie dhe qasshmëri të komunës tregon për angazhimin e komunës për të qenë në shërbim të qytetarëve. Komunat përmbushin një pjesë të kërkesave ligjore për publikimin e informatave dhe dokumenteve. Megjithatë, shpeshherë ato informata janë publikuar në formate të cilat nuk janë adekuate për kërkim dhe përpunim. Prezantimi i të dhënave të hapura nga komunat do të mundësojë përpunim më të lehtë të të dhënave, dobi më të madhe për komunitetin dhe transparencë më të madhe të komunës. Të dhënat e hapura janë një prej angazhimeve më të rëndësishme në Programin për partneritet të hapur qeveritar të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Përcaktimi afatgjat për transparencë të komunës duhet të inkorporohet në dokument konkret të miratuar nga këshilli i komunës, i cili do të përshkruajë në mënyrë deklarative përmes cilave forma dhe mekanizma komuna do të shpërndajë informata, do t'i konsultojë qytetarët dhe do t'i ofrojë shërbimet, si dhe pjesë operative ku do të përshkruhen mënyrat e realizimit të këtij përcaktimi, me çka qytetarët do të informohen, ndërsa procedurat e komunës do të jenë të parashikueshme. Informimi dhe parashikueshmëria janë të dy parakushtet themelore

për nxitjen e pjesëmarrjes qytetare dhe për realizimin e të drejtës kushtetuese të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në miratimin e vendimeve.

Kjo nënsferë përmban tregues për politikën themelore të komunës për transparencë dhe llogaridhënie, si: ekzistimi i përcaktimit strategjik të komunës për të qenë transparente dhe llogaridhënëse; investimi në edukimin e punëtorëve komunalë në temën e transparencës dhe llogaridhënies; ekzistimi i parakushteve themelore për informimin e qytetarëve dhe prezantimi i të dhënave të komunës në format të hapur. Njësitë e vetëqeverisjes lokale plotësojnë 36% të treguesve të përfshirë në nënsferën angazhimi për transparencë dhe llogaridhënie. Ueb faqet e komunave janë vendi primar ku qytetarët kanë qasje për të marrë të dhëna dhe informata për funksionimin e komunave ose për të realizuar disa nga të drejtat apo detyrimet e tyre. Ligji për qasje të lirë në informata me karakter publik ka paraparë që poseduesit e informatave, përfshirë edhe komunat, të sigurojnë transparencë aktive duke i publikuar të gjitha informatat publike që i prodhojnë ose i posedojnë në ueb faqen e komunës.

Sipas kësaj, ueb faqet e komunave janë mjeti më i rëndësishëm për informim dhe NJVL-të duhet doemos të sigurohen se ky mjet është funksional dhe i dobishëm për vizitorët. Sondazhi edhe për vitin 2022 tregoi se një pjesë e NJVL-ve duhet ta përmirësojnë cilësinë e ueb faqeve të tyre dhe t'i bëjnë të përshtatshme për përdoruesit. Një pjesë e madhe e ueb faqeve të komunave ende nuk i përmbajnë informatat themelore të cilat kërkohen me ligj; një pjesë e tyre si komuna e Krivogashtanit, nuk janë regjistruar në domenin gov.mk; disa komuna kanë dy ueb faqe; një pjesë e ueb faqeve nuk i përmbushin kërkesat për siguri kibernetike dhe numër i madh nuk kanë mjete funksionale për kërkim. Një pjesë e komunave nuk i përditësojnë rregullisht të gjitha versionet gjuhësore të ueb faqeve, përkatësisht informatat nuk publikohen në mënyrë konsekuente dhe nuk janë të arritshme në të gjitha gjuhët zyrtare të komunës. Shumica e komunave nuk kanë njëfarë dokumenti (strategji, politikë, procedurë) në lidhje me transparencën. Komunat, gjithashtu, duhet të investojnë më shumë në edukimin e të punësuarve në tema si transparenca, llogaridhënia, të dhënat e hapura etj.

Lidhur me rajonet e planit dhe në nënsferën angazhimi për transparencë dhe llogaridhënie, më lartë janë vlerësuar NJVL-të në Rajonin juglindor të planit (53%), e më ulët janë vlerësuar komunat në rajonin e Shkupit (27%).

Grafiku 7:
Transparenca e rajoneve të planit në nënsferën angazhimi për transparencë dhe llogaridhënie për vitin 2022



Në nënsferën angazhimi për transparencë dhe llogaridhënie, sondazhi tregoi se vlera mesatare është 36%, rezultate më të mira kanë komunat e Vallandovës dhe Bogdancit (86%) dhe komuna e Krushevës (73%), e më ulët janë vlerësuar komuna e Zelenikovës (9%), Dollenit

(5%) dhe Krivogashtanit (0%). Përgjithësisht, mund të konkludohet se ueb faqet e komunave janë të kufizuara në funksionalitetin dhe dobinë e tyre. Shumica e ueb faqeve nuk janë të lehta për përdorim dhe vizitorët shpesh nuk mund të arrijnë lehtë dhe shpejt në të dhënat e nevojshme. Komunat duhet të përpunojnë njëfarë dokumenti në të cilin do ta dokumentojnë përcaktimin e tyre strategjik për të qenë transparentë dhe llogaridhënës.

3.2.2. Informata organizative

Qasshmëria në informatat themelore për kompetencat e komunës, dokumentet themelore për punën dhe çështjet kadrovike janë obligim ligjor i komunave. Me këto të dhëna qytetarët i marrin informatat themelore për funksionimin e komunës, kontaktet themelore të miratuesve të vendimeve dhe personave që janë të ngarkuar për zbatimin e tyre. Në fakt, me këto të dhëna jepet pasqyrë kryesore për punën e komunës, sferat e veprimit të saj dhe matet qasshmëria dhe gatishmëria e nëpunësve komunalë për qytetarët. Në pajtim me kornizën ligjore në vendin tonë NJVL-të kanë për obligim mbledhjen e numrit të madh të të dhënave dhe mbajtjen e evidencave. Nëse këto të dhëna nuk janë të kufizuara me Ligjin për mbrojtje të të dhënave personale duhet të publikohen në ueb faqet e komunave. Kjo nënsferë përmban tregues që kanë të bëjnë me: të dhënat themelore për punën e komunës; informatat themelore për trupa të ndryshëm komunalë: kryetari i komunës, këshilli, ndërmarrjet publike, bashkësitë lokale, çështjet kadrovike dhe struktura organizative. Njësitë e vetëqeverisjes lokale përmbushin 49% të treguesve të përfshirë në nënsferën e informatave organizative. Në përgjithësi komunat publikojnë informata të kufizuara për punën e tyre të ueb faqeve. NJVL-të shpesh publikojnë dokumente themelore për punën e komunës si Statuti, Rregullorja, organogrami, të dhënat në lidhje me anëtarët e Këshillit dhe ngjashëm, por jo gjithmonë në vend të dukshëm dhe të parashikueshëm që e vështirëson dukshëm kërkimin. Ende ka komuna të cilat në ueb faqen e komunës nuk e kanë publikuar Statutin e komunës. Numër shumë i vogël i komunave në ueb faqet e tyre publikojnë informata të hollësishme për ndërmarrjet publike dhe punën e tyre, si dhe për projektet që i implementon komuna, veçanërisht ato që financohen me mjete nga buxheti qendror. Në lidhje me rajonet e planit, në nënsferat informatat organizative më lart janë vlerësuar NJVL-të në Rajonin juglindor (60%), e më ulët komunat në rajonin e Shkupit (41%).

Grafiku 8:

Transparenca e rajonit të planit në nënsferat informata organizative



Në nënsferat informatat organizative, sondazhi tregoi se vlera mesatare është (49%) dhe është më e lartë në lidhje me nënsferat tjera të transparencës, e rezultate më të mira kanë komuna e Ohrit (88%), Velesit (82%) dhe Dellçevës (81%), e më lart janë vlerësuar komuna e Haraçinës dhe Vrapçishtes me (11%) dhe komuna e Zelenikovës dhe Krivogashtanit me (0%).

Mund të konkludohet se komunat e ueb faqeve duhet të publikojnë të dhëna për resurse njerëzore, si për shembull lista të plota të të punësuarve me të dhëna për kontakt, të dhëna për personat e angazhuar me kontrata në vepër, kontrata për punë të përkohshme dhe kontrata autoriale. Gjithashtu, duhet të përfshihen më shumë informata të detajuara për ndërmarrjet publike për këshillat drejtuese dhe mbikëqyrëse për kompensimet e tyre dhe punën e tyre.

3.2.3. Miratimi i vendimeve

Qytetarët shpesh i drejtohen kryetarit të komunës, sepse edhe në pajtim me Ligjin për vetëqeverisje lokale, kryetari i komunës e përfaqëson komunën dhe udhëheq me administratën komunale, por edhe për shkak të perceptimit se ai është bartësi më me ndikim i vendimeve në komunën.

Roli i Këshillit si miratues i vendimeve dhe politikave anashkalohet më së shpeshti.

Kjo nënsferë përmban tregues të cilat kanë të bëjnë me qasshmërinë e të dhënave lidhur me procesin e miratimit të vendimeve, përkatësisht transparencën e mbledhjeve të Këshillit, arritshmërinë e dokumenteve dhe vendimet e miratuara, komunikimin me mediat dhe qytetarët nga Këshilli dhe kryetari i komunës.

Njësitë e vetëqeverisjes lokale përmbushin 27% të treguesve të përfshirë në nënsferat e miratimit të vendimeve. Pas transparencës financiare e cila renditet më lart, ky është rezultat i dytë i ulët në lidhje me katër nënsferat në sferën e transparencës.

Sondazhi tregoi se komunat publikojnë shumë pak të dhëna lidhur me procesin e miratimit të vendimeve nga Këshilli dhe kryetari i komunës. Kjo është sferë e rëndësishme e cila duhet të përmirësohet sepse me qasshmëri më të madhe të informatave për vendimet e Këshillit dhe kryetarit të komunës, njoftim në kohë për punën e tyre, qytetarët marrin mundësi për përfshirje në miratimin e politikave publike në nivel lokal.

Në lidhje me rajonet e planit, në nënsferat miratimi i vendimeve më lart janë vlerësuar NJVL-të në rajonin juglindor (42%), ndërsa më ulët komunat në Rajonin e Pollogut (13%). Në lidhje me vitin e kaluar në komunat nga të gjitha rajonet e planit është vërejtur rënie të indeksit në nënsferat miratimi i vendimeve, mesatarisht për 6%.

Grafiku 9:
Transparenca e rajoneve të planit në nënsferat miratimi i vendimeve



Në nënsferat miratimi i vendimeve, komunat me renditje më të lartë janë: Manastiri, Likova, Dellçeva, Kriva Pallanka dhe Bogdanci (70%), në këtë nënsferë bile 16 komuna rurale janë vlerësuar me 0%.

Është i dukshëm fakti se ka komuna të cilat nuk kanë sistem të vendosur të publikimit të informatave për punën e komunës megjithëse kjo paraqet obligim të tyre ligjor. Këto të dhëna janë një prej të dhënave më të rëndësishme të cilat komunat duhet t'i publikojnë rregullisht dhe në kohë sepse ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e jetesës në komunitetet lokale dhe mundësojnë ndjekje të punës së kryetarit të komunës dhe këshillit nga qytetarët dhe palët e interesuara.

3.2.4. Transparenca financiare

Qasshmëria në dhe dukshmëria e të gjitha informatave financiare: buxhetet, llogaritë përfundimtare, raportet financiare dhe prokurimet publike janë obligim ligjor i komunave dhe ndërmarrjeve publike. Planifikimi dhe shpenzimi i parave publike në mënyrë transparente është angazhim i një pjese të komunave dhe vërehen praktika të mira të publikimit të informatave në format adekuat të arritshëm dhe të kuptueshëm për qytetarët dhe përfshirje të qytetarëve në caktimin e prioriteteve për planifikim financiar. Njësitë e vetëqeverisjes lokale përmbushin vetëm 26% të indikatorëve të përfshirë në nënsferën transparencë financiare. Në vitin 2022 kjo nënsferë është me rendje më të ulët.

Komunat duhet të publikojnë më shumë të dhëna dhe informata për buxhetin dhe shpenzimin e parave publike sepse kjo kontribuon për uljen e korrupsionit, si dhe për sigurimin e pjesëmarrjes efektive të qytetarëve në proceset e buxhetimit. Sondazhi tregoi se 19 komuna nuk e kanë publikuar buxhetin rrjedhës të komunës në ueb faqen e saj. Shumica e NJVL-ve duhet ta përmirësojnë procesin e buxhetimit participativ me qëllim qytetarët të përfshihen në procesin e hartimit të buxhetit dhe planifikimit hapësinor. Me atë, qytetarët mund të përfshihen në pjesën më të rëndësishme të ndërtimit të politikave në nivel lokal. Vetëm 16 komuna kanë publikuar buxhet qytetar, me çka shkurtohet mundësia që qytetarët në mënyrë të thjeshtë përmes grafikëve dhe ilustrimeve ta kuptojnë buxhetin. Komunat nuk publikojnë të dhëna për rrogat e funksionarëve dhe kompensimeve të anëtarëve të Këshillit të komunës, si dhe link në listat anketuese.

Në lidhje me rajonet e planit, në nënsferat transparencës financiare janë vlerësuar më lart NJVL-të në Rajonin juglindor (36%), e më ulët komunat në Rajonin Verilindor (13%).

Grafiku 10:
Transparenca e rajoneve të planit në nënsferat transparenca financiare



Në nënsferën transparenca financiare, sondazhi tregoi se rezultate më të mira kanë komuna e Vallandovës (74%), Manastirit (69%) dhe Koçanit (64%), e më ulët janë vlerësuar komuna e Dollnenit, Tetovës, Krivogashtanit, Petrovacit, Zelenikovës, Butelit, Haraçinës dhe Vrapçishtës të cilat nuk publikojnë kurrfarë informatash lidhur me treguesit për transparencë financiare ose (0%).

Mund të konkludohet se komunat duhet të publikojnë më shumë informata financiare si raporte tremujore dhe vjetore financiare, informata ose linqe për punën financiare të ndërmarrjeve publike, mjete të alokuara për organizata civile, të dhënat për rrogat e funksionarëve dhe kompensimet e anëtarëve të këshillit të komunës. Një pjesë e komunave duhet ta avancojnë llogaridhënien në publikimin e informatave lidhur me prokurimet publike, përkatësisht t'i publikojnë planet për prokurimet publike, thirrjet, vendimet, marrëveshjet dhe anekset.

3.3. VETËDIJA

"Vetëdija" ka të bëjë me cilësinë e planifikimit, programimit, monitorimit dhe evaluimit të politikave që zbatohen nga institucionet. Parashikueshmëria e realizimit të interesit publik përmes politikave publike është me rëndësi esenciale për qytetarët. Që të arrihet parashikueshmëria në miratimin e vendimeve në nivel lokal, nevojitet që paraprakisht të planifikohen qëllimet të cilat dëshiron t'i arrijë NJVL-ja dhe të njëjtat të vihen në dokumentin strategjik i cili është i publikuar dhe i arritshëm për qytetarët. Në bazë të qëllimeve bëhet vlerësimi i politikave publike duke përdorur mjetet për monitorim dhe evaluim për të vlerësuar efikasitetin dhe efektivitetin e politikave publike në realizimin e qëllimeve të përcaktuara. Kjo sferë e shqyrton procesin e krijimit të politikave publike në komunën, hartimin dhe miratimin e dokumenteve strategjike, plan veprimeve, si dhe zhvillimin e planit dhe mjeteve për monitorim dhe evaluim gjatë zbatimit të kompetencave sektoriale të cilat i ka komuna.

Sondazhi tregoi se NJVL-të kanë vlerësim mesatar nga 13% në lidhje me përmbushjen e treguesve nga sfera e vetëdijes. Kjo është sferë në të cilën komunat kanë rezultat më të dobët. Në lidhje me planifikimin dhe programimin, komunat kanë përmbushur 17% të kritereve, ndërsa vetëm 5% në lidhje me monitorimin dhe evaluimin. Në lidhje me planifikimin dhe programimin, komunat kanë përmbushur 17% të kritereve, e vetëm 5% në lidhje me monitorimin dhe evaluimin. Bile 32 NJVL ose 40% të komunave nuk publikojnë kurrfarë dokumentesh dhe të dhënash në këtë sferë. NJVL-të punojnë shumë pak në mbledhjen dhe publikimin e të dhënave për efektivitetin e politikave, shkallën e tyre të zbatimit të ndikimit të tyre. Në pajtim me këtë, është e domosdoshme që komunat të implementojnë mekanizma sistematike të cilat rregullisht i vlerësojnë ndikimin, shpenzimet dhe efektet e politikave dhe si të tillë shërbejnë për zhvillimin e planeve strategjike për të ardhmen duke u mbështetur në të dhënat si dëshmi.

Grafiku 11:
Ndërgjegjësimi i NJVL-ve në Maqedoninë e Veriut sipas të dyja nënsferave



Grafiku 12:
10 komunat me renditje me të lartë në sferën e vetëdijes



Edhe në sferën e vetëdijes, komuna e Vallandovës renditet më lartë, me (68%) kritere të përmbushura, e dyta është e Krushevës me (61%), e në vendin e tretë është Struga me (51%). Në dhjetë të parat janë edhe komuna e Vasilevës, Prilepit, Kavadarit, Berovës, Konçes, Koçanit dhe Gradskos.

Rreth 32 komuna nuk publikojnë asnjë informatë që identifikohet me këtë sferë, përkatësisht ka të bëjë me planifikimin dhe programimin ose monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të dokumenteve strategjike: Komuna e Tetovës, Tearcës, Dollnenit, Demir Hisarit, Dojranit, Makedonska Kamenicës, Strumicës, Krivogashtanit, Novacit, Dibrës, Negotinës, Makedonski Brodit, Karbincit, Bogovinës, Pehçevës, Vrapçishtes, Probishtipit, Mavrovës dhe Rostushës, Haraçinës, Petrovecit, Kratovës, Kërçovës, Rankovces, Bërvenicës, Sarajit, Sopishtes, Nagoricanit të Vjetër, Pllasnicës, Studeniçanit, Zelenikovës, Aerodromit, Jegunovces, Butelit kanë (0%) përmbushje të kritereve.

Sfera e vetëdijes i përfshin nënsferat në vijim:

- Planifikimi dhe programimi, përkatësisht hartimi i programit për punë të komunës, dokumenteve strategjike për zhvillim të treguesve për ndjekje;
- Monitorimi dhe evaluimi (realizimi i planeve vjetore, njoftimi, shfrytëzimi i treguesve për matje të suksesit të zbatimit të politikave).

3.3.1. Planifikimi dhe programimi

Dokumentet strategjike janë parakusht ose condition sine qua non për zhvillim të qëndrueshëm të çdo bashkësie lokale. Të njëjtët duhet të jenë në korrelacion me dokumentet strategjike dhe janë bazë për procesin e programimit dhe buxhetimit në bazë vjetore. Këto dokumente duhet të miratohen përmes procesit të etabluar i cili do të bazohet në inkluzivitet në të cilin do të jenë të përfshirë të gjithë faktorët relevantë në komunitet.

Qasshmëria në këto dokumente (nëse miratohen ato) për qytetarët është hap ndaj përfshirjes më të madhe të qytetarëve në miratimin e vendimeve, ndërsa ekzistimi i treguesve përkatës për ndjekje dhe evaluim të dokumenteve tregon nivelin e cilësisë së tyre.

Planifikimi strategjik duhet të lidhet ngushtë me procesin e përgatitjes së buxhetit të komunave. Praktika e planifikimit të buxheteve pa kornizë strategjike përkatëse rezulton me buxhete të planifikuara joreale, që rezulton me borxhe të mëdha.

Sondazhi tregon se shumica e komunave nuk i publikojnë dokumentet e nevojshme strategjike dhe të planit dhe nuk kanë plan të shkruar i cili i përcakton qëllimet për zhvillim (Strategjia për zhvillim) dhe/ose plan veprim për realizim të Strategjisë për zhvillim. Duke e pasur parasysh kapacitetin e komunave mund të supozohet se disa prej komunave nuk kanë miratuar dokumente strategjike të cilat janë obligim ligjor i NJVL-ve.

Në lidhje me rajonet e planit në nënsferën planifikim dhe programim më lart janë vlerësuar NJVL-të në rajonin e planit Juglindor (34%), ndërsa më ulët janë vlerësuar komunat në rajonin e Pollogut (3%).

Grafiku 13:

Përmbushja e indikatorëve në nënsferën planifikim dhe programim në rajonet e planit



Megjithëse krahasuar me vitin 2021 në këtë nënsferë komunat kanë rezultate më të mira, janë evident të dhënat se komunat nuk kanë praktikë të publikimit të këtyre dokumenteve të cilat janë udhërrëfyes për programet dhe buxhetet vjetore.

3.3.2. Monitorimi dhe evaluimi

Me çdo proces të planifikimit strategjik duhet të finalizohet me matricën e monitorimit dhe evaluimit përmes treguesve SMART për validizimin e progresit në sferën e caktuar e cila është edhe bazë për politikat publike të bazuara në dëshmi përmes të cilës validizohet suksesi i politikës publike. Komunat kanë mungesë evidente në këtë nënsferë për të cilën përveç vullnetit politik nevojiten kapacitete njerëzore dhe ekspertizë në vetë administratën komunale, por edhe në bashkësinë lokale.

Sipas sondazhit për vitin 2022 vlera mesatare në këtë nënsferë është 5%. Vetëm 14 komuna nga gjithsej 81 përdorin njëfarë tregues për sukses gjatë hartimit të planeve vjetore për punë dhe raportet për punë.

Në lidhje me rajonet e planit, në nënsferën monitorim dhe evaluim më lart janë vleruar NJVL-të në Rajonin jugperëndimor (18%), e më lart komunat në Rajonin verilindor dhe Rajonin e Pollogut (0%).

Grafiku 14:
Përmbushja e treguesve në nënsferën monitorim dhe evaluim në rajonet e planit



Komunat duhet të investojnë më shumë në rrjetëzimin me kapacitetet ekzistuese në bashkësinë lokale (institucione të arsimit të lartë, OJQ), në instrumentin bashkëpunim ndërkomunal në funksion të përmirësimit të kapaciteteve të monitorimit dhe evaluimit të politikave publike lokale.

3.4. QASSHMËRIA

Qasshmëria është parim i rëndësishëm i menaxhimit të mirë sepse është bazë për politika lokale transparente, inkluzive dhe llogaridhënëse. Politikat për qasshmëri etablohen në legjislativin nacional përmes qasjes së lirë në informata, të dhënave të hapura, dhe obligimit për zbatimin e procesit konsultativ, formimit të trupit në të cilin marrin pjesë qytetarët, bashkësitë lokale dhe referendumit për çështje në kompetencë të vetëqeverisjes lokale.

Sondazhi në këtë domen u përqendrua në tre nënsferat:

- Qasja në informatat dhe shërbimet, ku bëjnë pjesë qasja e lirë në informatat me karakter publik, qasshmëria e shërbimeve dhe informimi i qytetarëve për punën e komunave;
- Konsultime publike, të cilat i përfshijnë mundësitë e ndryshme për përfshirje të qytetarëve në procesin e miratimit të vendimeve nga kryetari i komunës dhe Këshillit, punën e komunës dhe planifikimin e buxhetit;
- Bashkëveprimi me qytetarët, përkatësisht mundësitë për komunikim të dyanshëm ndërmjet komunave dhe qytetarëve përmes mjeteve me dedikim dhe mediave sociale, qasshmërisë së kryetarit të komunave dhe organeve komunale.

Në sferën e qasshmërisë vlera mesatare është 24% me vlerësim më të lartë për treguesit për nënsferën bashkëveprim me qytetarët me 34%, e vlerësim më të ulët për nënsferat tjera, përkatësisht qasja në informatat dhe shërbimet 24% dhe konsultimet publike 14%.

Grafika 15:
Qasshmëria e NJVL-ve sipas tre nënsferave



Sipas konstatimeve nga sondazhi komuna me renditje më të lartë është Demir Hisari (58%) ndërsa me renditje më të ulët është komuna e Krivogashtanit (0%).

Grafiku 16:
10 komunat me renditje më të lartë në sferën qasshmëria



Për shkak të qasshmërisë më të madhe në informatat në ueb faqen e komunës duhet të publikohen: Të dhëna për personin zyrtar për qasje të lirë në informata me karakter publik (emri dhe mbiemri, posta elektronike dhe telefoni), formularët për parashtrim të kërkesës, lista e informatave me karakter publik e komunës (gjithçka që është publikuar në ueb faqen, sipas kategorive dhe sipas mundësive në formë të linkut në informatën e njëjtë), materiale informative për realizimin e të drejtës së qasjes në informata, udhëzimi/rregullorja për konsultime dhe kalendari vjetor i konsultimeve. Të gjithë këto informata të publikohen në vend të dukshëm ose të shënohen me baner të veçantë.

3.4.1. Qasja në informata dhe shërbime

NJVL-të janë të obliguara, sipas rregullativës ligjore, kryesisht nëpërmjet Ligjit për vetëqeverisje lokale, ta informojnë rregullisht publikun për punën e tyre, si dhe për planet dhe programet që janë të rëndësishme për zhvillimin e bashkisë, por edhe detyrimet që dalin nga ligji sektorial për të krijuar të dhëna nëpërmjet mbajtjes së regjistrave dhe evidencave. Gjithashtu, njësitë e vetëqeverisjes lokale janë të detyruara që qytetarëve t'u ofrojnë qasje në informatat bazë për shërbimet që ua ofrojnë. Rezultatet e NJVL-ve nga sondazhi tregojnë përmbushje 24% të treguesve që lidhen me nënsferën qasja në informata dhe shërbime. Duke marrë parasysh se treguesit në këtë nënsferë janë detyrime ligjore të cilat janë të rregulluara në mënyrë normative, kjo përqindje tregon zbatim jo të plotë të legjislacionit pozitiv në këtë sferë. Shumica e komunave nuk publikojnë regjistrat, bazat e të dhënave, informatat nga sfera të ndryshme që kanë detyrim ligjor t'i krijojnë dhe mbajnë. Nevojitet një analizë më e detajuar nëse ato i gjenerojnë, përkatësisht kanë kapacitet për të gjeneruar këto të dhëna dhe grupe të dhënash. Është evident fakti se shumë NJVL kanë vështirësi t'i realizojnë kompetencat që dalin nga neni 22 i Ligjit për vetëqeverisje lokale, si rrjedhojë kjo çështje ka të bëjë me kapacitetin e kryerjes së kompetencës.

NJVL-të nuk i publikojnë informatat në ueb faqet e saj. Bile 31 komuna nuk kanë publikuar listë të informatave me karakter publik në ueb faqen e tyre.

Në lidhje me rajonet e planit, në nënsferën qasja në informatat dhe shërbimet NJVL-të vlerësim më të lartë kanë në rajonin e Pellagonisë (32%), e vlerësim më të ulët komunat në rajonin e Shkupit (19%).

Grafiku 17:
Përmbushja e treguesve në nënsferën qasja në informata dhe shërbime në rajonet e planit



3.4.2. Konsultime publike

Procesi i konsultimeve është baza e demokracisë lokale, përkatësisht si pushtet më i ulët që është më i afërt me qytetarët, komuna përmes procesit të konsultimeve publike mundëson përfshirje të qytetarëve në identifikimin e prioriteteve të komunës por edhe vlerësim të efektit të politikave publike. Në pajtim me BVL-në, ky proces realizohet përmes përfshirjes individuale ose kolektive të banorëve të komunës në vendimmarrje për punët me rëndësi lokale në nivele të ndryshme të vendimmarrjes.

Më konkretisht, NJVL-të kanë për obligim që procesin e konsultimeve ta realizojnë përmes iniciativës qytetare, anketave, mbledhjeve të qytetarëve dhe referendumit. Njëkohësisht, komunat kanë për obligim t'u mundësojnë qytetarëve të parashtrojnë parashtresa dhe propozime për punën e organeve të komunës dhe administratës komunale.

Përveç këtyre mekanizmave BVL-ja përcakton nevojë për formimin e dy trupave participative dhe atë: Komisioni për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive (e detyrueshme për komunat në të cilat së paku 20% të numrit total të banorëve të komunës të përcaktuar në regjistrimin e fundit të realizuar të popullsisë janë pjesëtarë të komunitetit të caktuar) dhe Këshilli për Mbrojtje të Konsumatorëve si trup participativ dhe këshillimor për shqyrtimin e çështjeve dhe përcaktim të propozimeve të cilat kanë të bëjnë me cilësinë e shërbimeve të nëpunësve publikë të komunës. Paralelisht edhe në ligjet sektoriale janë paraparë një sërë mekanizmash për konsultim të qytetarëve në politikat publike (arsimi, mjedisi jetësor, planifikimi urbanistik, mbrojtja sociale, zhvillimi ekonomik lokal etj). Ky proces merr përmasa të reja me trendët globale të digjitalizimit të procesit të konsultimeve publike.

Sondazhi tregoi se NJVL-të kanë vlerësim të ulët 14% në nënsferën e konsultimeve publike. Krahasuar me vitin 2021 ky vlerësim është më i ulët për 4%. Shumica prej 50%, përkatësisht 42 komuna nuk kanë publikuar asnjë të dhënë në këtë nënsferë.

Analiza tregon se komunat as nuk i publikojnë këto mekanizma e as nuk janë të gatshme t'i digjitalizojnë, përkatësisht t'i realizojnë proceset e e-konsultimeve (e-anketë, e-takim, e-parashtresë, e-forum, e-konsultime).

Lidhur me rajonet e planit në nënsferën konsultime publike vlerësim më të lartë kanë komunat në rajonin Juglindor (26%), e vlerësim më të ulët komunat në rajonin e Pollogut (5%).

Grafiku 18:
Përmbushja e treguesve në nënsferën konsultime publike në rajonet e planit



3.4.3. Bashkëveprimi me qytetarët

Në këtë nënsferë janë përfshirë tregues që vlerësojnë nëse komunat përdorin mjete të ndryshme për bashkëveprim me qytetarët siç janë mediat sociale dhe nëse fusin mjete bashkëveprimi për komunikim në ueb faqet e tyre.

Përmes bashkëveprimit me publikun mundësohet marrje e përgjegjshme e informatave kthyese nga qytetarët si shfrytëzues të fundit.

Sondazhi tregoi NJVL-të kanë vlerësim prej 34% në nënsferën bashkëveprim me qytetarët. Sipas sondazhit, 39 komuna nuk kanë kanal të drejtpërdrejt "online" për komunikim me të cilin qytetarët mund të dorëzojnë parashtresa dhe ankesa. Bile 71 komuna janë përgjigjur se në vitin e fundit nuk kanë vepruar sipas propozimit të marrë përmes ndonjë mjeti. Shumica e komunave kanë profile zyrtare në Facebook, e një pjesë kanë edhe profile në rrjete tjera sociale.

Lidhur me këtë nënsferë vlerësim më të lartë kanë komunat në rajonin e Pellagonisë (47%), e vlerësim më të ulët komunat në rajonin Verilindor (23%).

Grafiku 19:
Përmbushja e treguesve në nënsferën bashkëveprimi me qytetarët në rajonet e planit



Komunat duhet që përpjekjet e tyre t'i orientojnë në e-mjetet për komunikim me qëllim nxitjen e bashkësisë lokale që të përdorë e-konsultime paralelisht me mënyrën tradicionale dhe joformale të konsultimit. Mekanizmat e partneritetit privato-publik, reklamimi në ueb faqen komunale, përgjegjësia sociale dhe korporatave dhe bashkëpunimi ndërkomunal janë disa prej qasjeve në komunat ku ka mungesë të mjeteve njerëzore dhe financiare për digjitalizim të bashkëveprimit me qytetarët.

3.5. INTEGRITETI

Integriteti përkatësisht politikat e integritetit janë parakusht për besimin publik në autoritetet lokale si dhe për realizim të plotë dhe të papenguar të të drejtave dhe lirive të qytetarëve si dhe nxitjen e pjesëmarrjes së tyre në miratimin e vendimeve në nivel lokal, në njësinë e tyre të vetëqeverisjes lokale. Në kontekst të vetëqeverisje lokale, politika e integritetit të komunës duhet ta promovojë në nivel politik dhe administrativ, si bazë për nxitjen e sjelljes etike, rezistencës ndaj korrupsionit, krijimit të kushteve për zhvillim shoqëror, pjesëmarrjes

së qytetarëve në vendimmarrje për nevojat dhe interesat lokale dhe besim më të madh të qytetarëve në NJVL-të.

Kjo nënsferë përmban tregues të cilat tregojnë ekzistimin dhe qasjen e politikës për integritet dhe politikës së antikorrupsionit, edukimit të punëtorëve administrativë në këtë temë, kodit etik të nëpunësve administrativë dhe funksionarëve lokalë dhe parandalimit të konfliktit të interesave. Rezultatet e NJVL-ve nga sondazhi tregojnë 23% përmbushje të treguesve që kanë të bëjnë me sferën e integritetit. 21 nga gjithsej 81 NJVL nuk publikojnë kurrfarë të dhënash në këtë sferë. Nevojiten analiza plotësuese nëse ato kanë miratuar politika të integritetit ose nuk kanë miratuar dokumente për integritet. Bile 60 NJVL në ueb faqen nuk publikojnë informata për sponsorime dhe donacione, e vetëm në 11 komuna në vitin e kaluar të punësuarit në administratën komunale kanë ndjekur trajnim në temën e konfliktit të interesave ose korrupsionit. Në ueb faqet e 48 komunave nuk publikohen informata të hollësishme për shpallje për punësim dhe persona të sapopunësuar (me pika në procedurën) në 12 muajt e kaluara. Në sferën integriteti, komuna me renditje më të lartë është Vallandova me 86%, ndërsa 21 komuna nuk kanë publikuar kurrfarë të dhënash në këtë sferë.

Grafiku 20:
10 komunat me renditje më të lartë në sferën e integritetit



Lidhur me rajonet e planit, në sferën e integritetit më lart janë vlerësuar NJVL-të nga rajoni Juglindor me 42% ndërsa më ulët janë vlerësuar komunat në rajonin Verilindor 16%.

Grafiku 21:
Përmbushja e treguesve në sferën e integritetit në rajonet e planit.



3.6. TË DHËNA TË HAPURA

Të dhënat e hapura janë në qendrën e konceptit të Qeverisë së hapur dhe Qeverisjes së hapur. Ato kontribuojnë drejtpërdrejt në rritjen e transparencës së NJVL-ve, përmirësimin i shërbimeve publike, nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe efikasitetit më të madh të punës së administratës. Në pajtim me Ligjin për përdorim të të dhënave nga sektori publik komunat janë të obliguara që të publikojnë vazhdimisht të dhëna të hapura.

Me këtë sferë horizontale " të dhënat e hapura" indeksi i analizon praktikat e komunave për transparencë të të dhënave që i publikojnë. Indeksi i shpërblen komunat që kanë angazhim për publikimin e informatave në format të hapur të cilat janë të përpunueshme lehtë nga pikëpamja teknike. Sondazhi tregoi se asnjë NJVL nuk ka më shumë se 50% të treguesve të përfshirë në sferën e të dhënave të hapura. Megjithatë krahasuar me vitin 2021 ka përmirësim të dukshëm të rezultateve. Nëse në vitin 2021 komuna më e mirë kishte 27% në vitin 2022 Demir Hisari është me renditje më të mirë me 40% ndërsa më ulët është komuna e Krivogashtanit me 0%. Bile 32 komuna kanë nën 10% përmbushje të treguesve në këtë kategori.

Grafiku 22:
10 komunat me renditje më të lartë në sferën e të dhënave të hapura



3.7. KËSHILLAT KOMUNALE DHE NDËRMARRJET PUBLIKE

Raporti fokusohet edhe në transparencën e këshillave komunale dhe ndërmarrjeve publike si mjete të rëndësishme të pushtetit lokal.

Këshilltarët përveç si miratues të vendimeve, përfaqësues të qytetarëve kanë rol të rëndësishëm edhe në kryerjen e mbikëqyrjes së punës së administratës komunale dhe institucioneve themelues të të cilave është komuna.

Në përgjithësi, suksesi, efikasiteti dhe transparenca në punën e këshillit varet nga mbështetja e administratës komunale e cila është nën udhëheqësinë e kryetarit të komunës.

Në atë drejtim, në disa komuna këshillat dhe informatat lidhur me punën e këshillit dhe këshilltarëve nuk janë transparentë për shkak të mbështetjes së pamjaftueshme nga administrata komunale. Megjithatë Indeksi i transparencës së këshillave është më i lartë (32%) krahasuar me Indeksin kumulativ të komunave (27%). Komuna me renditje më të lartë në këtë kategori (transparencë të këshillave) është ajo e Vallandovës me 71%, ndërsa komuna me renditje më të ulët janë e Zelenikovës dhe e Krivogashtanit me 0%.

Lidhur me ndërmarrjet publike, edhe në vitin 2022 është konstatuar mungesë evidente e informatave në ueb faqet e komunave. Disa komuna nuk publikojnë kurrfarë informatash për punën dhe buxhetimin e ndërmarrjes publike. Megjithatë krahasuar me vitin 2021 ka përmirësim të dukshëm, sipas konstatimeve nga sondazhi rezultati mesatar i rezistencës së ndërmarrjeve publike është 21%. Komuna me renditje më të lartë në këtë kategori (rezistenca e ndërmarrjeve publike) është komuna e Vasilevës me 69%, ndërsa me renditje më të ulët janë komuna e Sopishtes, Haraçinës, Krivogashtanit, Rankovces, Butelit dhe Çairit me 0%.

4.
KONKLUZION

Edhe krahas kornizës ligjore pozitive e cila jep bazë normative solide për vendosjen e parimeve për qeverisje të mirë në nivel lokal, para së gjithash në pjesën e transparencës dhe integritetit, sondazhi i Indeksit të transparencës për vitin 2022 tregon se niveli i ulët i përmbushjes së parimeve të qeverisjes së mirë nga NJVL-të vazhdon pa ndryshime të dukshme në lidhje me vitin 2021.

Megjithëse rritet vetëdija te qytetarët për nevojën për transparencë dhe llogaridhënie më të madhe në punën e pushteteve lokale, si dhe për qasje në shërbimet administrative në formë elektronike, sondazhi tregon se komunat nuk investojnë përpjekje dhe resurse të mjaftueshme për përmirësimin e transparencës në qeverisjen.

Komunat duhet ta rrisin transparencën në punën e tyre, e veçanërisht në publikimin e të dhënave në lidhje me vendimet që i miraton kryetari i komunës dhe Këshilli, dokumenteve strategjike dhe të planit, dokumenteve për ndjekje dhe matje të efektivitetit të politikave, të dhënave në lidhje me punën financiare, si dhe të dhënat që sigurojnë integritet më të madh në punën.

Gjithashtu, komunat në ueb faqet e tyre duhet që qytetarëve t'u sigurojnë informata për të gjitha shërbimet që i siguron komuna, si dhe mënyrën për qasje në to, me kontakt nga njësia organizative dhe personat përgjegjës të ngarkuar për shërbimin konkret. Theks i veçantë duhet të vihet në sigurimin e qasjes në shërbimet elektronike, për të cilën është e domosdoshme një qasje e koordinuar në mënyrë sistematike në nivel horizontal ndërmjet ministrive kompetente, si dhe në nivel vertikal, ndërmjet pushteteve qendrore dhe lokale, me qëllim të sigurimit të resurseve të domosdoshme njerëzore dhe teknike për transformim digjital të komunave.

Kjo e rrit përdorimin e TIK-së për përmirësimin e transparencës në punën e komunave. Ueb faqet e komunave janë mjeti themelor i komunave për informimin e qytetarëve dhe duhet të zhvillohen në nivel të lartë që të paraqesin mjet funksional dhe të dobishme për vizitorët.

Ato duhet t'i përmbushin kërkesat për siguri kibernetike dhe të jenë të përshtatshme për nevojat e përdoruesve.

Nevojitet që komunat të punojnë më shumë në rritjen e transparencës dhe punën e tyre ta bazojnë në parimet e transparencës, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes, të cilët të ndihmuar nga teknologjitë dhe novacionet e reja do ta avancojnë qeverisjen publike dhe do ta përforcojnë administratën publike dhe demokracinë.

Zhvillimi i planeve strategjike të komunave duhet të bazohet në të dhënat e marra nga burimet relevante, për të cilën duhet të sigurohet sistemi i cili komunave do t'ua transferojë të dhënat nga sfera të ndryshme (punësim, kujdes social, subjekte të regjistruara ekonomike, institucione shëndetësore, kulturore dhe institucione tjera, si dhe të dhëna tjera) të cilat kanë të bëjnë me territorin e komunës. Komunat duhet të krijojnë baza të tyre të të dhënave për lëvizje në sferat e kompetencës së tyre në bazë të të cilave do të mund të planifikojnë dhe të

programojnë, të vendosin qëllime reale, të bazuara në të dhënat relevante, por edhe për të bërë monitorim dhe evaluim gjatë implementimit të politikave.

Ueb faqet e komunave duhet të përmbajnë informata dhe të dhëna më të hollësishme të cilat kanë të bëjnë me punën e ndërmarrjeve publike të themeluara nga komuna, për organet administrative dhe mbikëqyrëse, për shërbimet që i sigurojnë dhe për çmimet e shërbimeve.

Kryesisht për shkak të mungesës së resurseve njerëzore, por edhe organizimit joadekuat të administratës, në numrin më të madh të komunave, në veçanti në ato rurale, gjen zbatim të vështirë korniza ligjore në sferat që janë përfshirë me sondazhin, para së gjithash Ligjin për qasje të lirë në informatat me karakter publik, Ligjin për shfrytëzimin e të dhënave në sektorin publik dhe rregullativën ligjore për punën financiare të NJVL-ve.

Në atë kuptim paraqitet nevoja që përmes akteve normative plotësuese ose dokumenteve të ndihmohet në operacionalizimin e ligjeve, me atë që do të adresohen në mënyrë më të drejtpërdrejtë informatat me karakter publik të cilat dalin nga kompetencat e komunave dhe organeve të komunës.

Gjithashtu, është e domosdoshme që ueb faqet të sigurojnë mjete për komunikim të drejtpërdrejtë, proaktiv me qytetarët, si dhe për konsultim të tyre duke përdorur teknologjitë e reja që do të sigurojë përfshirje dhe inkluzivitet më të madh gjatë miratimit të vendimeve.

Ajo që mundon tani por është e rëndësishme për sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies më të madhe është publikimi i të gjitha informatave të cilat do të sigurojnë integritet më të madh në punën e pushteteve lokale dhe administratës lokale.

Nëse merren parasysh rezultatet nga sondazhi të grupuara në nivel të rajonit të planit, nevojiten të bëhen përpjekje të dukshme nga NJVL-të në rajonin e Shkupit dhe të Pollogut për kuptim më të madhe dhe për përmirësim të transparencës në punën e tyre.

5.

REKOMANDIMET PËR QEVERISJE TË MIRË TË VETËQEVERISJES LOKALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Me qëllim të përmirësimit të transparencës së komunave në vazhdim janë cekur rekomandimet që duhet të shërbejnë si plan gjithëpërfshirës për qeverisje të mirë në nivel lokal.

TRANSPARENCA

- Të përgatitet dokument i vetëm ose akt nënligjor, i cili do t'u referohet të gjitha komunave dhe i cili do t'i përfshijë të gjitha informatat të cilat komunat duhet t'i publikojnë në ueb faqen e tyre. Në këtë mënyrë do të sigurohet barazia, parashikueshmëria dhe krahasimi i informatave të cilat do të publikohen.
- Ueb faqja do të jetë mjeti themelor i komunës për informimin e publikut për punën e organeve të komunës, për shërbimet që i siguron, përfshirë edhe ato shërbime që i siguron përmes shërbimeve publike, si dhe për informata dhe të dhëna tjera që dalin nga kompetencat që i kanë komunat.
- Ueb faqet e komunave të zhvillohen në pajtim me rekomandimet dhe standardet nacionale dhe ndërkombëtare, përfshirë edhe standardet që e lehtësojnë qasjen në personat me shikim të dëmtuar dhe të meta tjera, të njëjtat të jenë funksionale dhe të përditësohen rregullisht.
- Ueb faqja duhet të jetë e arritshme në të gjitha gjuhët të cilat janë në përdorim zyrtar në komunën, e sipas mundësisë edhe në gjuhën angleze. Përmbajtjet të cilat publikohen në gjuhë të ndryshme duhet të jenë identike dhe të përditësohen njëkohësisht;
- Personi përgjegjës për sigurimin e transparencës aktive, duke i publikuar të gjitha informatat publike në ueb faqen e komunës, duhet të jetë personi zyrtar për qasje në informatat me karakter publik,
- Ueb faqja duhet të përditësohet çdo ditë, pas çdo ndryshimi të bërë të dokumentit apo aktit, si dhe dy herë në vit duke kontrolluar të gjitha informatat e publikuara.
- Përgjegjëse për përditësimin e përmbajtjeve janë njësitë organizative që krijojnë ose posedojnë informata dhe të cilat për çdo ndryshim e njoftojnë personin përgjegjës për qasje të lirë në informata me karakter publik.
- Ueb faqet e komunave duhet të plotësojnë kërkesat e sigurisë kibernetike;
- Bashkitë duhet të kenë njësi organizative të veçantë që do të jetë drejtpërdrejt përgjegjëse për ofrimin e kushteve për qeverisje të hapur, përmes transparencës dhe qasjes në informata me karakter publik.
- Komunat duhet të ofrojnë trajnime të vazhdueshme për personat përgjegjës për transparencë dhe llogaridhënie në mënyrë që të ngritin nivelin e të kuptuarit të materies, si dhe për veprim të drejtë dhe ligjor.
- Të dhënat që publikohen në ueb faqen duhet të jenë të strukturuara mirë dhe të publikuara brenda menyve dhe seksioneve të ueb faqes në mënyrë që të jenë të lehta për t›u gjetur;

- Të publikohen sa më shumë të dhëna në format të hapur, për të cilat është e nevojshme që të dhënat, gjatë krijimit dhe sistemimit të tyre, të futen në një format që do të mundësojë publikimin dhe përdorimin e tyre të lehtë (minimum pasqyrë tabelore).
- Komunat t›i publikojnë grupet e të dhënave (të dhënat e hapura) që i krijojnë në ueb faqet e tyre, si dhe në portalin nacional për të dhëna të hapura - data.gov.mk;
- Për të siguruar transparencë aktive, komunat duhet të kenë publikuar në ueb faqen informatat në vijim:
  - rendi i ditës për mbledhjet, si dhe procesverbalet dhe informatat tjera lidhur me punën e Këshillit;
  - listat e plota të pozitave dhe kontakteve të të gjithë zyrtarëve të punësuar me informacione kontakti (emri dhe mbiemri, pozicioni, seksioni/sektori, numri i zyrës, telefoni zyrtar dhe e-mail);
  - punësimet e përkohshme, si dhe personat e angazhuar me kontratë në vepër ose kontratë të autorit,
  - kompetencat e komunës;
  - shërbimet që i ofron komuna,
  - informata për anëtarët e këshillit, si dhe për komisionet e këshillit dhe trupat e tjerë të punës,
  - informata për ndërmarrjet dhe institucionet publike të themeluara nga komuna (këshilli drejtues dhe mbikëqyrës dhe kompensimet);
  - vendimet e miratuara nga ana e kryetarit të komunës dhe këshillit të komunës;
  - video ose audio shënime nga mbledhjet e Këshillit, si dhe ndjekja e tyre e drejtpërdrejtë,
  - Propozim-buxheti të publikohet bashkë me buxhetin qytetar, që qytetarët ta kuptojnë më lehtë;
  - Buxheti menjëherë pas miratimit të tij,
  - Raport tremujor dhe vjetor për realizimin e Buxhetit nga viti paraprak,
  - Të gjitha dokumentet për prokurime publike (planet për prokurime publike, thirrje, vendime, anekse etj) ose minimum link në Portalin e vetëm elektronik për prokurime publike në të gjitha prokurimet publike të komunës konkrete;
  - biografitë, rrogat dhe linku në listat anketuese të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar,
  - informatat për procedurat për ankande publike, koncesione ose PPP.
  - informatat për financimin e projektit ose shërbimeve nga organizatat civile për financimin e fondacioneve dhe klubeve sportive.

VETËDIJA

Për vetëdijesim më të madh për qëllimet e vendosura nga komuna dhe për shkallën e realizimit të tyre si dhe për efektet e arritura. Në ueb faqen duhet të publikohen:

- Vizioni dhe misioni për zhvillimin e komunës,
- Dokumentet strategjike dhe programore të komunës, me qëllime dhe rezultate të definuara qartë, me implikime buxhetore dhe tregues për matje të rezultateve,
- Programet vjetore për punën e komunës me aktivitete dhe afate konkrete dhe implikime buxhetore,
- Raporte vjetore për punën e kryetarit të komunës dhe të Këshillit të cilët do të japin pasqyrë çfarë është realizuar në lidhje me aktivitetet e planifikuara, me sa mjete dhe në cilat afate që të mund të matet suksesi.

QASSHMËRIA

Për qasshmëri më të madhe në informatat në ueb faqen e komunës duhet të publikohen:

- Të dhënat për personin zyrtar për qasje të lirë në informatat me karakter publik (emri dhe mbiemri, e-maili dhe telefoni), formularët për parashtrimin e kërkesës, lista e informatave me karakter publik (gjithçka e publikuar në ueb faqen, sipas kategorive dhe mundësive në formë lidhjeje në të njëjtën informatë), materialet informuese për realizimin e së drejtës së

qasjes në informata të karakterit publik. Të gjithë këto informata të publikohet në një vend të dukshëm ose të shënohen me baner të veçantë..

- Të dhënat për person përgjegjës për mbështetje të personave me aftësi të kufizuar në komunikimin me administratën komunale,
- Katalogu i shërbimeve të cilat i siguron komuna me kontakt në njësitë organizative kompetente dhe nëpunësit përgjegjës,
- Qasja e dukshme në e-shërbimet ose formularët për qasje në shërbimet me sqarim preciz për mënyrën e sigurimit të shërbimeve,
- Kalendar vjetor për konsultime të planifikuara, si dhe sqarim të rregullt të raporteve pas konsultimeve të bëra,
- Mënyra e komunikimit të kryetarit të komunës dhe anëtarëve të këshillit me qytetarët (ditë të hapura, përmes postës elektronike, telefonit ose përmes mjetit elektronik në ueb faqen)
- Mjeti elektronik për raportim të problemit me mundësi për komunikim të dyanshëm,
- Adresa zyrtare, posta elektronike dhe telefoni për komunikim me komunën.

INTEGRITETI

Për sigurimin e kushteve për punë të organeve të komunës dhe administratës komunale me integritet (rezistenca e korrupsionit dhe konfliktit të interesave) në ueb faqen e komunës duhet të publikohen:

- Dokumenti programor i cili do t'i identifikojë rreziqet nga korrupsioni dhe konflikti i interesave dhe do të propozojë masa dhe aktivitete konkrete për reduktimin e tyre,
- Akti për kufizim të pranimit të dhuratave nga kryetari i komunës, anëtarët e këshillit dhe administratës lokale (shuma dhe posedimi, në pajtim me ligjin)
- Regjistri i dhuratave të pranuara,
- Evidenca e rasteve të raportuara të konfliktit të interesave nga anëtarët e këshillit ose kryetarit të komunës,
- Deklarata për raportimin e konfliktit të interesave,
- Personi i autorizuar për raportim të brendshëm të mbrojtur, me kontakt informata,
- Evidenca për pronë të tundshme dhe të patundshme të komunës,
- Procedura e shfrytëzimit të automjeteve zyrtare,
- Procedura e raportimit dhe miratimit të mungesës zyrtare dhe private në vendin e punës,
- Procedura e shfrytëzimit të celularëve zyrtarë,
- Konkurset për punësim, kandidatët e paraqitur, përzgjedhja e kryer dhe vendimi për punësim të kandidatit,
- Thirrjet publike për projekte, përzgjedhje, caktim të pikave, projekte të miratuara, shfrytëzues dhe vlera,
- Prokurime publike me dokumentacion të plotë (kushtet, përzgjedhja, marrëveshja, anekset e marrëveshjes)
- Sponsorime dhe donacione.

SHTOJCA 1: STRUKTURA E INDEKSIT TË TRANSPARENCËS NË NIVEL LOKAL

NËNSFERA: ANGAZHIMI PËR TRANSPARENCË DHE LLOGARIDHËNIE

1. A përditësohet rregullisht ueb faqja?
2. A publikohen informatat në mënyrë të barabartë në të gjitha gjuhët zyrtare?
3. A është funksional motori i kërkimit të faqes kryesore?
4. A ka komuna ndonjë dokument (strategji, politikë, procedurë) në lidhje me transparencën?
5. Vitin e fundit, të punësuarit në komunë a kanë ndjekur trajnime apo ndonjë lloj tjetër edukimi për qasje në informata me karakter publik?
6. Vitin e fundit a kanë marrë pjesë të punësuarit në komunë në trajnim/punëtori për nëpunësit administrativë mbi konceptin e të dhënave të hapura dhe udhëzimet se si të shfrytëzohen dhe publikohen të dhënat në një format të hapur?
7. A ka emëruar komuna zyrtarë të të dhënave të hapura?
8. A publikon komuna grupe të dhënash të hapura në data.gov.mk?

NËNSFERA: INFORMATA ORGANIZATIVE

9. A është i publikuar në ueb faqe organogrami i komunës?
10. A janë të publikuara në ueb faqe kompetencat e komunës?
11. A është e publikuar në ueb faqe biografia e kryetarit të komunës?
12. A është i publikuar në ueb faqe statuti i komunës?
13. A është i publikuar në ueb faqe këshilli komunal?
14. A janë të publikuara në ueb faqe informatat për emrat, pozitat dhe kontaktet e nëpunësve administrativë?
15. A janë publikuar në ueb faqe informatat për personat e angazhuar me kontratë në vepër, kontratë për punë të përkohshme dhe kontratë të autorit?
16. A janë publikuar në ueb faqe informatat për anëtarët e Këshillit me emër, fotografi dhe kontakt?
17. A është publikuar lista e ligjeve që kanë të bëjnë me kompetencat e komunës?

18. A janë publikuar në ueb faqe informatat për pjesëmarrje të komunës në ndërmarrjet publike?

19. A janë publikuar në ueb faqe emrat dhe kontaktet e kryetarëve të bashkësive lokale/urbane?

20. A janë publikuar në ueb faqen informatat për komisione dhe trupa pune të Këshillit?

21. A është publikuar statuti i ndërmarrjeve komunale publike?

22. A janë publikuar informatat për anëtarë të këshillit drejtues dhe mbikëqyrës të ndërmarrjes komunale publike?

NËNSFERA: MIRATIMI I VENDIMEVE

23. A janë publikuar në ueb faqe agjendat e ditës për mbledhjet e Këshillit?

24. A janë publikuar në ueb faqe shënimet nga mbledhja e Këshillit?

25. A janë publikuar në ueb faqe vendimet e miratuara nga Këshilli?

26. A transmetohen drejtpërdrejt mbledhjet e Këshillit përmes transmetimit audio dhe video?

27. A janë publikuar në ueb faqe audio/video shënimet nga mbledhjet e Këshillit në vitin e fundit?

28. A është publikuar në ueb faqe së paku një njoftim/deklaratë për mediat nga mbledhja e Këshillit në tre muajt e fundit?

29. A publikohen rregullisht njoftimet për takimet e realizuara zyrtare me informata të hollësishme nga takimi?

NËNSFERA: TRANSPARENCA FINANCIARE

30. A është i publikuar buxheti komunal për vitin rrjedhës?

31. A e ka publikuar komuna buxhetin qytetar për vitin rrjedhës?

32. A është dorëzuar vendimi për buxhetin në Këshill para 1 dhjetorit në vitin rrjedhës?

33. A publikohen raporte tremujore për realizimin e buxhetit?

34. A është publikuar në ueb faqe llogaria përfundimtare?

35. A publikohen informata për huamarrja të komunës?

36. A janë publikuar në ueb faqe planet për prokurime publike?

37. A janë publikuar në ueb faqe thirrjet për ueb faqen?

38. A janë publikuar në ueb faqe vendimet për prokurime publike?

39. A janë publikuar në ueb faqe kontratat për prokurime publike?

40. A janë publikuar në ueb faqe anekset e kontratave për prokurime publike?

41. A janë publikuar në ueb faqe planet dhe programet financiare vjetore për realizim të buxhetit?

42. A janë publikuar në ueb faqe raportet e Entit Shtetëror të Revizionit?

43. A është publikuar në ueb faqe informata për rrogat e funksionarëve?

44. A është publikuar në ueb faqen e komunës të paktën një informatë për koncesionet, PPP-të apo ankandet publike vitin e fundit?

45. A janë publikuar në ueb faqe raportet për realizimin e planit të për prokurime publike?

46. A ka publikuar komuna të paktën një thirrje për projekte për organizatat civile vitin e kaluar?

47. A janë publikuar në ueb faqen vendimet për mjetet e alokuara për organizatat civile?

48. A është publikuar llogaria vjetore e ndërmarrjes publike?

49. A është publikuar akti me të cilin përcaktohen çmimet për shërbimet e shoqërisë publike?

50. A është publikuar akti për shfrytëzimin e të ardhurave të realizuara të ndërmarrjes komunale publike?

51. A është publikuar llogaria përfundimtare e ndërmarrjes komunale publike?

52. A është e arritshme për qytetarët informata për kompensimet e anëtarëve të këshillit të komunës?

53. A është e arritshme për qytetarët rregullorja për pagesën e shpenzimeve të udhëtimeve dhe shpenzimeve ditore për udhëtime zyrtare brenda dhe jashtë vendit për anëtarët e këshillit dhe nëpunësit shtetërorë?

SFERA: VETËDIJA

NËNSFERA: PLANIFIKIMI DHE PROGRAMIMI

54. A është i publikuar në ueb faqe programi vjetor i komunës për vitin rrjedhës

55. A është i publikuar në ueb faqe programi i Këshillit Komunal për vitin rrjedhës

56. A janë të publikuara në ueb faqe strategjitë komunale (që kanë të bëjnë edhe me vitin rrjedhës)

57. A ka komuna dokument të shkruar gjithëpërfshirës ku i vendos qëllimet e saj (Strategjia për zhvillim ose Plani zhvillimor) që ka të bëjë me vitin rrjedhës?

58. A ka publikuar komuna plan veprim për realizim të Strategjisë për zhvillim?

59. A ka publikuar program investues vjetor për vitin rrjedhës të ndërmarrjes komunale publike?

60. A përdor ndërmarrja komunale publike tregues të suksesit gjatë zhvillimit të programit vjetor?

61. A përdor komuna tregues të suksesit gjatë zhvillimit të programit vjetor?

NËNSFERA: MONITORIMI DHE EVALUIMI

62. A është i publikuar në ueb faqe raporti për punën e kryetarit të komunës për vitin paraprak?

63. A është i publikuar në ueb faqe raporti për punën e Këshillit për vitin paraprak?

64. A është i publikuar në ueb faqe raporti për punën e ndërmarrjes komunale publike për vitin paraprak?

65. A shfrytëzon komuna tregues të suksesit gjatë zhvillimit të raporteve vjetore për punën e vitit paraprak?

SFERA: QASSHMËRIA

NËNSFERA: QASJA NË INFORMATAT DHE SHËRBIMET

66. A i publikon komuna propozim planet e detajuara urbanistike në territorin e komunës?

67. A i publikon komuna planet e detajuara urbanistike të miratuara në territorin e komunës?

68. A e ka publikuar komuna regjistrin e organizatave civile?

69. A e ka publikuar komuna listën e veprimtarive hoteliere të vëllimit të vogël?

70. A e ka publikuar komuna listën e veprimtarive turistike të vëllimit të vogël

71. A e ka publikuar komuna listën e shërbimeve në turizmin fshataresk, etno dhe ekologjik?

72. A ka publikuar komuna të dhëna për zonat industriale në territorin e komunës?

73. A ka publikuar komuna Kadastrën e mjedisit jetësor?

74. A ka publikuar komuna Regjistrin e lejeve të ndara të integruara ekologjike – B?

75. A ka publikuar komuna Regjistër të ndotësve?

76. A ka publikuar komuna kadastër të shkaktuesve të zhurmës?

77. A ka publikuar komuna kadastër të krijuesve të mbeturinave?

78. A ka publikuar komuna të dhëna për transportuesit dhe mjetet motorike për kryerje të transportit të udhëtarëve dhe mallrave në komunikacionin rrugor?

79. A ka publikuar komuna të dhëna për tregjet në territorin e komunës?

80. A ka publikuar komuna të dhëna për depot në territorin e komunës?

81. A ka publikuar komuna të dhëna për parkingjet në territorin e komunës?

82. A ka publikuar komuna regjistër të kopshteve për fëmijë në komunën?

83. A ka publikuar komuna regjistër të shkollave fillore në komunën?

84. A ka publikuar komuna regjistër të shkollave të mesme në komunën?

85. A ka publikuar komuna të dhëna për azilet e pleqve në territorin e komunës?

86. A janë publikuar në ueb faqe raportet për mbikëqyrje të kryer inspektuese?

87. A janë publikuar në ueb faqe informatat për institucione për mbrojtje të kategorive të ndryshme të qytetarëve?

88. A janë publikuar në ueb faqe informatat për numrin e shfrytëzuesve të ndihmës sociale (sipas kategorive)?

89. A është publikuar në ueb faqe Regjistri i mbeturinave (licenca të lëshuara)?

90. A janë publikuar në ueb faqe qendra grumbullimi për mbeturina elektrike dhe elektronike?

91. A janë të publikuara licencat e lëshuara për largimin e makinave të dëmtuara dhe me defekt nga rrugët komunale dhe lokale?

92. A është publikuar raporti vjetor për lejet e lëshuara të ndërtimit?

93. A është publikuar Regjistri i lejeve të lëshuara për vendosjen e objekteve të përkohshme dhe pajisjeve urbane?

94. A është publikuar Regjistri i kërkesave të paraqitura për përcaktimin e statusit juridik të objekteve pa leje?

95. A është publikuar Regjistri i emrave të rrugëve dhe numri i objekteve, shesheve, urave dhe objekteve tjera infrastrukturore?

96. A është publikuar regjistri i administruesve të ndërtesave banesore?

97. A janë publikuar informata për objektet sportive në territorin e komunës?

98. A janë publikuar informata për klubet sportive?

99. A është publikuar Regjistri i monumenteve përkujtimore?

100. A janë publikuar informata për institucionet komunale në fushën e kulturës?

101. A është publikuar Regjistri i personave fizikë që kryejnë veprimtari turistike, ciceronëve dhe shoqëruesve turistikë?

102. A është publikuar Regjistri i objekteve të kategorizuara hoteliere?

103. A është publikuar evidenca e hotelierëve?

104. A janë publikuar në ueb faqen të dhënat e kontaktit për personin përgjegjës për qasje në informatat me karakter publik?

105. A janë publikuar përgjigjet anonime për pyetjet për të cilat është miratuar qasje në informatat me karakter publik?

106. A është publikuar procedura (mënyra) për marrjen e informatave me karakter publik?

107. A ka ueb faqja meny (seksion) të veçantë për të drejtën e qasjes në informata me karakter publik?

108. A ka komuna gazetë të saj mujore (ose informator) (elektronike apo në letër)?

109. A janë publikuar në ueb faqe përgjigjet e pyetjeve të parashtruara shpesh?

110. A është publikuar në ueb faqe Lista e informatave me karakter publik?

111. A janë siguruar shërbime elektronike në ueb faqen?

112. A është publikuar në ueb faqe lista e shërbimeve të ofruara nga komuna (fizike dhe elektronike)?

113. A janë publikuar në ueb faqe formularë për qasje në shërbimet?

114. A është publikuar lista e tarifës për kompensime për lëshimin e akteve?

115. A janë publikuar në ueb faqen informata për kushtet dhe kriteret për përdorimin e shërbimeve sociale dhe marrjen e ndihmës në para?

116. A është publikuar emri dhe kontakti i personit përgjegjës për kontaktin me personat me aftësi të kufizuara?

NËNSFERA: KONSULTIME PUBLIKE

117. A u publikua në ueb faqe thirrja për pjesëmarrje në konsultimin publik për buxhetin?

118. A është publikuar në ueb faqe raporti për konsultim publik i mbajtur për propozim-buxhetin e fundit?

119. A janë të arritshme në ueb faqe planet për konsultime publike për vitin rrjedhës të komunës?

120. A janë publikuar thirrjet për debate publike?

121. A mund të gjinden në ueb faqe informata të nevojshme për diskutim publik nga viti rrjedhës?

122. A ka mbajtur komuna konsultime publike për propozim-buxhetin e fundit?

123. A janë publikuar në ueb faqe raportet e detajuara nga diskutimet publike (janë shkruar sqarime dhe përgjigje të komenteve dhe sugjerimeve)?

124. A organizon komuna forum të komunitetit (ose forum buxhetor, si formë e forumit të komunitetit)?

NËNSFERA:
BASHKËVEPRIMI ME QYTETARËT

125. A ekziston byro/zyrë për kontakt me qytetarët?

126. A ka përcaktuar kryetari i komunës orë pranuese për konsultime me qytetarët?

127. A ka komuna profil aktiv në Facebook?

128. A ka komuna profil aktiv në media tjetër sociale?

129. A janë publikuar në ueb faqe udhëzimet për dorëzim të parashtresave dhe ankesave?

130. A ekziston kanal i drejtpërdrejtë komunikimi online në ueb faqe përmes të cilit qytetarët do të mund të dorëzojnë parashtresa dhe ankesa?

131. A ka vepruar komuna vitin e fundit për propozim të marrë përmes ndonjë prej mjeteve për pjesëmarrje qytetare (iniciativa qytetare, mbledhja e qytetarëve, referendumi, parashtresa dhe propozime)?

SFERA:
INTEGRITETI

NËNSFERA:
POLITIKAT PËR INTEGRITET DHE KONFLIKT TË INTERESAVE

133. A është publikuar plan për integritet ose ndonjë praktikë tjetër të brendshme antikorruptive (që përfshin masa për parandalim dhe eliminim të formave të ndryshme të sjelljes korruptive dhe joetike në institucion)?

134. A është publikuar në ueb faqe Kodi Etik për funksionarë lokalë dhe nëpunës administrativë?

135. A janë publikuar në ueb faqe emri dhe kontakti i personit i ngarkuar për raportim të brendshëm të mbrojtur?

136. A është publikuar në ueb faqe emri dhe kontakti i personit të ngarkuar për parregullsi?

137. A janë publikuar në ueb faqe informatat për sponsorime dhe donacione nga komuna?

138. A publikohen konkurse për punësim dhe persona të sapopunësuar me pika në procedurën në 12 muajt e kaluar?

139. A kanë ndjekur të punësuarit vitin e kaluar trajnim/punëtori ose aktivitete tjera edukative në temat si konflikti i interesave/parandalimi i korrupsionit, sugjerimi në rast të parregullsive?

Fondacioni për internet dhe shoqëri Metamorfozis është fondacion i pavarur, jopartiak dhe joprofitabil me seli në Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut. Misioni i tij është të kontribuojë për zhvillimin e demokracisë dhe rritjen e cilësisë së jetës përmes shfrytëzimit dhe ndarjes novatore të diturisë. Vlerat tona kryesore janë transparenca, barazia dhe liria.

Sferat programore në të cilat vepron Metamorfozis janë:

- Mediat për demokraci
- Edukimi për novacione
- Përgjegjësia shoqërore
- Të drejtat e njeriut në internet

Fondacioni për internet dhe shoqëri Metamorfozis rr. Apostoll Gusllarot, nr. 40, 1000 Shkup, Maqedonia e Veriut email info@metamorphosis.org.mk tel: +389 2 3109 325

ФОНДАЦИЈА МЕТАМОРФОЗИС
ул. „Апостол Гусларот" бр. 40
1000, Скопје, Северна Македонија
телефон: +389 2 3109 325